



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Projekti " Fuqizimi i Këshillave Komunal - Faza 2"

Udhëzime operative për komunat për paraqitjen e interesimit për pjesëmarrje në projekt

Skema e Granteve Komunale (SGK) 2022-2023

Qershor 2022



PËRMBAJTJA

Hyrja

1. Cili është qëllimi kryesor i projektit?
2. Kush mund të paraqet interesim për pjesëmarrje në këtë projekt?
 - 2.1. Kush nuk mund të paraqet interes për të marrë pjesë në projekt?
 - 2.2. Çështje të tjera që lidhen me pranueshmërinë e kërkesave
3. Cili është afati kohor për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara?
4. Përfitimi financiar dhe jo-financiar për pjesëmarrësit e projektit?
5. Bashkëfinancimi nga ana e komunave
6. Parakushtet kryesore për përzgjedhjen e komunave për pjesëmarrje në projekt
7. Shpenzimet të cilat nuk mbulohen nga projekti
8. Cili është afati kohor për thirrjen?
9. Ku të dorëzohet aplikacioni dhe afati i dorëzimit?
10. Vlerësimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e komunave
11. Si organizohet procedura e vlerësimit dhe përzgjedhjes?
12. Kriteret e vlerësimit
 - 12.1. Kriteret për përmbushjen e kushteve
 - 12.2. Kriteret për përzgjedhje
 - 12.3. Kriteret plotësuese
13. Lidhja e marrëveshjeve

Hyrje

Hulumtimet fillestare dhe analizat e bëra nga ana e UNDP-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare përmes metodave të ndryshme të hulumtimit, kanë treguar se në vitet e fundit është bërë njëfarë progresi, statusi, puna dhe efikasiteti i këshillave komunale nuk i plotësojnë tërësisht pritjet ligjore dhe praktike.

Përkatësisht, anëtarët e zgjedhur të këshillave komunale, veçanërisht ata të cilët zgjidhen në funksion për herë të parë / marrin mandat nuk posedojnë njohuri paraprake dhe gatishmëri të nevojshme për t'iu përgjigjur detyrave dhe sfidave me të cilat përballen në kryerjen e funksionit të tyre.

Nga ana tjetër, këshilltarët komunal, megjithëse janë zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta për të përfaqësuar qytetarët dhe interesat e tyre, ata shumë rrallë kanë ndërveprim të drejtpërdrejtë me zgjedhësit e tyre, ndërsa kontaktet dhe lidhja me këshilltarët nga komunat e tjera si mënyrë e komunikimit dhe përkrahjes reciproke pothuajse nuk ekzistojnë.

Në të njëjtën kohë, planifikimi dhe buxheti zakonisht bëhet nga administrata komunale, me ç'rast këshilltarët kryesisht në masë të madhe janë në rolin e vëzhguesve. Në këtë mënyrë, prioritetet për shpenzimin e fondeve komunale nuk janë subjekt i përfshirjes aktive dhe mbikëqyrjes publike.

Për më tepër mund të konkludojmë se këshillat komunale janë pjesë e një pasqyre më të madhe sociale në të cilën institucionet qeveritare në të gjitha nivelet dështojnë të përmbushin detyrimet e tyre për avancimin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave dhe të nxisin kohezionin në një shoqëri të larmishme dhe multietnike. Kuotat për listat zgjedhore kanë kontribuar në përfaqësimin e grave në këshillat lokale përafërsisht në një të tretën e të gjithë anëtarësisë, por çështjet e barazisë së burrave dhe grave ende rrallë vërehen në debatet e këshillave ose në vendimet për shpërndarjen e shpenzimeve të komunave. Numër i vogël i këshillave në vend kanë gra kryetare, ndërsa edhe funksionet ekzekutive kryesisht janë të plotësuara nga burrat. Vendimet për shpenzimin e fondeve komunale shpesh miratohen pa i marrë parasysh nevojat specifike të komuniteteve të ndryshme etnike.

Me qëllim të tejkalimit të mangësive të mësipërme, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) filloi zbatimin e fazës së dytë të projektit "Fuqizimi i këshillave komunal.

Projekti "Fuqizimi i Këshillave Komunal – Faza 2" është i financuar nga Ambasada Zvicerane dhe Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, ndërsa e implementon dhe bashkë-financon Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP). Partnerë tjerë në realizimin e projektit, janë Ministria e Financave, Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL), Shoqata e punëtorëve financiarë (AFO), UN Women, NALAS, organizatat e shoqërisë civile, si dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale në Maqedoninë e Veriut.

Qëllimi kryesor i projektit është mbështetja e zhvillimit e vetëqeverisjes lokale, kryesisht duke forcuar këshillat komunal të cilat do të jenë në gjendje të përmbushin në mënyrë efektive rolet e tyre të caktuara të përfaqësimit, mbikëqyrjes dhe vendimmarrjes komunale përmes përfshirjes së qytetarëve në mënyrë aktive.

Për më tepër, projekti synon edhe përmirësimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale, decentralizimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në bashkësitë lokale, duke përmirësuar politikat zhvillimore dhe kornizën ligjore për zhvillimin lokal dhe decentralizimin, digjitalizimin e shërbimeve komunale, rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal, si dhe luftën kundër korrupsionit.

Promovimi i parimeve të barazisë gjinore dhe mundësive të barabarta për të gjithë, kohezionit social, mbrojtjes së mjedisit, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndër-komunal dhe ndër-sektorial janë pjesë e temave transversale të këtij projekti.

Për të arritur rezultatet e pritura të projektit, aktivitetet do të zbatohen në tre komponentë të veçantë, përkatësisht:

Komponenti 1 - Përmirësimi sistematik dhe i qëndrueshëm i punës së këshillave komunale dhe avancimi i sistemit të vetëqeverisjes lokale;

Komponenti 2 - Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve për demokraci të qëndrueshme lokale dhe përmirësimi i jetës së të gjithë qytetarëve (gra dhe burra); dhe

Komponenti 3 - Përmirësimi i shërbimeve komunale përmes zbatimit të teknologjisë dhe inovacionit.

Gjatë kohëzgjatjes së projektit nga viti 2022 deri në vitin 2027, gjithsej 40 komuna do të përfshihen drejtpërdrejt në zbatimin e projektit. Komunitet partnere do të zgjidhen përmes thirrjeve publike dhe në bazë të kriterëve të paracaktuara për përzgjedhje (komuna urbane dhe rurale, numër i ndryshëm i banorëve, komuna nga rajone të ndryshme planore, komuna të udhëhequra nga pozita dhe opozita, etj.).

Kjo Thirrje për paraqitje të interesit për pjesëmarrje në projektin "Fuqizimi i Këshillave Komunal – Faza 2", u dedikohet komunave që nuk kanë qenë të përfshira drejtpërdrejt në kuadër të fazës së parë të projektit në periudhën 2016-2021.

Në këtë thirrje, në bazë të kushteve të parashikuara dhe përmbushjes së kriterëve për përzgjedhje, do të zgjidhen gjithsej 10 komuna të cilat do të përfshihen drejtpërdrejt në realizimin e aktiviteteve të projektit gjatë viteve 2022 dhe 2023. Me komunitet e zgjedhura UNDP do të nënshkruajë Memorandum Bashkëpunimi, sipas të cilit përcaktohen aktivitetet dhe detyrimet e palëve të përfshira.

Këto udhëzime operative ofrojnë procedurat dhe kriteret thelbësore për përzgjedhjen dhe pjesëmarrjen në projektin "Fuqizimi i Këshillave Komunal - Faza 2".

1. Cili është qëllimi kryesor i projektit?

Qëllimi kryesor i projektit është avancimi i mbështetjes së sistemit për zhvillimin e qeverisjes lokale, kryesisht duke forcuar këshillat komunal të cilat do të jenë në gjendje të përmbushin në mënyrë efektive rolet e tyre të caktuara të përfaqësimit, mbikëqyrjes dhe vendimmarrjes komunale përmes përfshirjes së qytetarëve në mënyrë aktive.

Për më tepër, projekti synon edhe përmirësimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale, decentralizimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në bashkësitë lokale, duke përmirësuar politikat zhvillimore dhe kornizën ligjore për zhvillimin lokal dhe decentralizimin, digjitalizimin e shërbimeve komunale, rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në nivelin lokal, si dhe luftën kundër korrupsionit.

2. Kush mund të shprehë interes për të marrë pjesë në projekt?

Në këtë thirrje mund të paraqesin interesimin të **gjitha komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut** të cilat nuk kanë qenë të përfshira drejtpërdrejt në kuadër të fazës së parë të projektit në periudhën 2016-2021.

2.1. Kush nuk mund të shprehë interes për të marrë pjesë në projekt?

Në këtë thirrje nuk mund të paraqesin interesimin 24 komuna¹ të cilat kanë qenë të përfshira drejtpërdrejt gjatë implementimit të fazës së parë të projektit në periudhën 2016-.

Në këtë thirrje nuk mund të paraqesin interesimin persona tjerë juridikë dhe fizikë të cilat nuk kanë statusin e njësisë së vetëqeverisjes lokale / komunë.

2.2. Çështje të tjera që lidhen me përgatitjen e aplikacioneve

Një komunë mund të paraqesë vetëm **një aplikim**. Vetëm komunitat e përzgjedhura do të nënshkruajnë **Memorandum për bashkëpunim dhe Marrëveshje për financim me zyrën e UNDP-së**.

Në bashkëlidhje të kërkesës duhet të dorëzohet edhe Letër për angazhim (Aneks 1 i aplikacionit) me nënshkrim nga Kryetari i Këshillit Komunal dhe Kryetari i Komunës dhe vula e komunës, mes tjerash edhe për respektimin e qëllimeve të projektit dhe parimeve të transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë gjatë zbatimit të projektit.

3. Cili është afati kohor për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara?

Kohëzgjatja e zbatimit të aktiviteteve me dhjetë komunitat e reja të përzgjedhura është **15 muaj**. Realizimi i aktiviteteve të projektit është planifikuar të fillojë në **shtator të vitit 2022** dhe të përfundojë në **nëntor të vitit 2023**.

Aktivitetet e veçanta me komunitat e përzgjedhura do të realizohen në **dy faza**, edhe atë:

- Faza e **parë** (në periudhën **shtator 2022 - mars 2023**) do të realizohen aktivitetet e planifikuara për fuqizimin e kapaciteteve të anëtarëve të këshillave komunalë përmes zbatimit të Programit për Zhvillim të Kapaciteteve, rrjetëzimit të këshilltarëve dhe përzgjedhjes së projekteve prioritare të bashkësive përmes qasjes participative (Forume në bashkësi),
- Faza e **dytë** (në periudhën **Prill - Nëntor 2023**) do të realizohen projektet prioritare të qytetarëve të përzgjedhura përmes Forumeve në bashkësi.

4. Përfitimet e pjesëmarrjes në projekt

Komunitat të cilat do të zgjidhen për të marrë pjesë në projekt do të kenë përfitime të caktuara jo-financiare dhe financiare.

Në suaza të përfitimeve jo-financiare, anëtarët e këshillave nga komunitat e përzgjedhura do të kenë mundësinë të marrin pjesë në trajnime, evente të rrjetëzimit të këshilltarëve, seminare dhe konferenca, dhe vizita studimore. Njëkohësisht, këshillat komunale dhe komunitat do të kenë mundësinë të marrin pjesë në aktivitete për ngritjen e nivelit të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare. Përfitimet e mësipërme do t'i ndihmojnë këshilltarët të rrisin kapacitetet tyre për të realizuar më me sukses përgjegjësitë dhe detyrat e tyre.

Gjithashtu, nga 10 komunitat e përzgjedhura, në baza vjetore projekti do të mbështesë:

- dy deri në tre komuna në përgatitjen ose revidimin e planeve dhe strategjive ekzistuese të zhvillimit lokal, dhe

¹ Vallandovë, Veles, Strumicë, Sveti Nikollë, Ohër, Çair, Bërvenicë, Gostivar, Qendër, Strugë, Kavadar, Koçan, Kumanovë, Mogillë, Zhelinë, Berovë, Manastir, Bogdanci, Vevçan, Gjorçe Petrov, Krushevë, Çashkë, Tetovë dhe Zërnovc.

- një komunë për vendosjen e së paku një forme të bashkëpunimit ndër-komunal (BNK mund të vendoset nga një komunë që është e përfshirë drejtpërdrejt në projekt me komuna tjera të cilat janë ose nuk janë të përfshira drejtpërdrejt në projekt).

Në kuadër të përfitimeve financiare, komunat do të përfitojnë mjete financiare në shumën e përgjithshme prej **50,000** deri në **70,000 USD**, në varësi të marrëveshjeve për implementim, përkatësisht:

- **10,000 deri në 12,000 USD** për të vendosur së paku një iniciativë ose mekanizëm inovativ për ngritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe pjesëmarrjes qytetare, dhe
- **40,000 deri në 60,000 USD në formë të grantit për projekte** (në varësi të llojit dhe madhësisë së komunave, përkatësisht: nga 40,000 USD deri në 50,000 USD për komunat rurale dhe komunat urbane deri në 25,000 banorë; dhe deri në 60,000 USD për komunat urbane me mbi 25,000 banorë) për realizimin e 1 deri në 3 projekteve prioritare të qytetarëve të përzgjedhur përmes qasjes participative - metodologjisë për zbatimin e Forumeve në bashkësi. Gjatë përcaktimit të numrit të popullsisë rezidente në komuna, do të shfrytëzohen të dhënat zyrtare të Entit për statistika nga regjistrimi i vitit .

5. Bashkëfinancimi nga komunat

Bashkëfinancimi (ko-financimi) është kusht për përzgjedhjen dhe pjesëmarrjen e komunave në projekt. Bashkëfinancimi për realizimin e projekteve prioritare të qytetarëve bëhet në vlerë financiare monetare në shumën e së paku 20% të vlerës së përgjithshme që do të përfitojë komuna në formë granti për projekte për realizimin e 1 deri në 3 projekteve prioritare në bashkësi të përzgjedhura përmes mekanizmit participativ - metodologjia për zbatimin e Forumeve në bashkësi.

Mjetet financiare që do të përfitojnë komunat e përzgjedhura në kuadër të kësaj thirrje do të menaxhohen në formë administrative nga UNDP.

Gjatë përzgjedhjes dhe realizimit të projekteve prioritare të qytetarëve në komunat partnere, do të bëhet përpjekje që të njëjtat të jenë në përputhje me planet ekzistuese të investimeve dhe iniciativat ekzistuese komunale në fushat në kompetencë të komunave.

6. Parakushtet kryesore për përzgjedhjen e komunave për pjesëmarrje në projekt

Parakushtet kryesore për pjesëmarrjen e komunave dhe shfrytëzimin e përfitimeve financiare dhe jo-financiare nga projekti janë:

- Pjesëmarrja aktive në të gjithë komponentët dhe aktivitetet e projektit;
- Gatishmëria dhe disponueshmëria/angazhimi i shprehur i anëtarëve të këshillave komunale dhe administratës komunale për pjesëmarrje në zbatimin e Programit për Zhvillimin e Kapaciteteve (trajtime) me pjesëmarrjen e së paku 60% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit komunal (një e treta gra, përfaqësimi i grupeve të ndryshme politike dhe etnike, etj.) ;
- Zbatimi i metodologjisë për Forumet në bashkësi dhe miratimi i këtij mjeti për pjesëmarrje qytetare në statutin e komunës (nëse nuk është i përfshirë);
- Sigurimi i mjeteve adekuate financiare për të mbuluar angazhimin e moderatorit të licencuar të forumeve dhe shpenzimeve tjera që lidhen me procesin e implementimit të Forumeve në bashkësi;
- Implementimi i projekteve të përzgjedhura / prioritare të qytetarëve, përfshirë përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm projektues-teknik, zbatimin e procedurave të prokurimit publik dhe mbikëqyrjen e zbatimit të projektit/eve;

- Instalimi i tabelës elektronike (e-dashboard) për publikimin e pasqyrave financiare për realizimin e buxhetit në ueb faqen e komunës dhe publikimi i rregullt i raporteve tremujore (K1, K2, K3);
- Përditësimi i rregullt i faqes së internetit të komunës me informacione lidhur me punën e Këshillit Komunal (rendet e ditës, procesverbale, vendime dhe dokumente të tjera relevante) si dhe të dhëna për anëtarët e këshillit komunal (numri i telefonit zyrtar, adresa e e-mailit, etj.).
- Sigurimi i mjeteve financiare në kuadër të buxhetit komunal për të mbështetur aktivitetet për promovimin dhe avancimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat.

7. Shpenzimet të cilat nuk mbulohen nga projekti

Shpenzimet e renditura më poshtë nuk do të mbulohen nga mjetet financiare të cilat do të përftohen nga komunat e përzgjedhura për pjesëmarrje në projekt – komunat partnere:

- shpenzimet për TVSH;
- paga për nëpunësit civilë dhe punonjësit në komuna;
- shpenzimet për organizimin dhe realizimin e procesit të forumit, përfshirë stafin dhe moderatorin dhe ko-moderatorin e forumit;
- shpenzimet për përgatitjen e projektit dhe dokumentacionit teknik për propozim-projektet;
- shpenzimet për mbikëqyrjen dhe raportimin mbi procesin e zbatimit të grantit të projektit.

8. Cila është korniza kohore për thirrjen?

Tabela e mëposhtme tregon orarin e zbatimit të aktiviteteve të projektit për 2022-2023:

Nr.	Aktiviteti	Afatet kohore
1.	Shpallja e thirrjes	21 Qershor 2022
2.	Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve	21 Korrik 2022, 16.00h.
3.	Vlerësimi dhe përzgjedhja	15 Gusht 2022
4.	Përgatitja dhe nënshkrimi i marrëveshjeve dhe fillimi i zbatimit të projektit	1 Shtator 2022
5.	Fundi i zbatimit të projektit	30 Nëntor 2023

9. Dorëzimi i aplikacioneve dhe afati i dorëzimit?

Komunat që do të paraqesin interes për pjesëmarrje në këtë projekt, duhet të dorëzojnë dosjen e plotësuar në përputhje me Udhëzimet operative dhe kërkesat që përmban Aplikacioni.

Aplikacioni i plotë duhet të përmbajë pjesët dhe dokumentet e mëposhtme:

- **Formulari i plotësuar** - Aplikim për paraqitjen e interesit për pjesëmarrje në projekt
- **Deklarata e angazhimit** - nënshkruar nga kryetari i komunës dhe kryetari i këshillit komunal (Aneksi 1)
- Lista e paraqitjes e së paku 60% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit komunal (një e treta gra, përfaqësimi i grupeve të ndryshme politike dhe etnike) të cilët kanë deklaruar

interesim për pjesëmarrje në Programi për zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të këshillave komunale në kuadër të projektit (Aneks 2).

Aplikacioni plotësohet dhe dorëzohet në gjuhën maqedonase ose në një të tjetër nga gjuhët tjera zyrtare në komunën aplikuese.

Në rast të paraqitjes së aplikacionit në gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, është e nevojshme të dorëzohet përkthimi i aplikacionit në gjuhën maqedonase.

Aplikimet dorëzohen në mënyrë elektronike, me e-mail në adresën e mëposhtme: fnisnik.shabani@undp.org. Afati i fundit i dorëzimit është **21 Korrik 2022, ora 16.00**.

Pranimi i çdo aplikacioni do të konfirmohet me përgjigje në e-mail nga UNDP brenda 24 orëve nga momenti i dorëzimit. Në rast të mos pranimit të një përgjigje për pranimin e aplikacionit nga UNDP-ja, dhe me qëllim që të shmangen gabimet e mundshme teknike, është e nevojshme të bëhet ri-dorëzimi i aplikacionit ose të kontaktoni personin përgjegjës të projektit përmes e-mailit fnisnik.shabani@undp.org me qëllim të konfirmimit të statusit të aplikacionit tuaj.

Asnjë aplikim nuk do të pranohet dhe nuk do të shqyrtohet pas afatit të përcaktuar.

Të gjitha pyetjet në lidhje me procedurën e aplikimit do të pranohen vetëm me shkrim përmes e-mailit. Përgjigjet e pyetjeve do të publikohen publikisht çdo të hënë (nga 27 Qershor deri më 11 Korrik) në faqen e internetit të UNDP-së <http://www.mk.undp.org>.

10. Vlerësimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e komunave

Vlerësimi dhe përzgjedhja e 10 komunave që do të marrin pjesë në projekt në periudhën 2022-2023 do të bëhet nga komisioni i vlerësimit dhe përzgjedhjes i përbërë nga përfaqësues të UNDP-së dhe Ambasadës Zvicerane/SDC. Lista e komunave të përzgjedhura do të shqyrtohet dhe konfirmohet nga Komiteti Drejtues i projektit në të cilin marrin pjesë përfaqësuesit e Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale (MVL), Ministrisë së Financave (MF), Komitetit të Këshillave të BNJVL-së, Ambasadës së Zvicrës dhe UNDP-së.

Vlerësimi i propozimeve bëhet në **dy faza**.

Faza e selektimit preliminar: Kjo është faza e parë në procesin e vlerësimit. Kjo fazë përbëhet nga shqyrtimi administrativ i aplikacioneve të pranuar për përmbushjen e kushteve, bazuar në listën e kriterëve për përmbushjen e kushteve (shiko 12.1).

- **Faza e përzgjedhjes:** Aplikimet që do të kalojnë fazën e para-përzgjedhjes, vazhdojnë me kontrollimin e kriterëve për përzgjedhje, bazuar në tabelën e vlerësimit (shiko 12.2). Ekipi i vlerësimit i vlerëson aplikimet duke dhënë pika për disa pyetje të caktuara, gjegjësisht, kriterë për përzgjedhje.

11. Si është organizuar procedura e vlerësimit dhe përzgjedhjes?

- UNDP i regjistron të gjitha aplikacionet që arrijnë.
- Ekipi i projektit të UNDP-së është përgjegjës për kontrollimin e aplikacioneve nga aspekti i pranueshmërisë administrative (përmbushja e kushteve) dhe për vlerësimin e cilësisë teknike të aplikacioneve.
- Anëtarët e komisionit të vlerësimit dhe përzgjedhjes nënshkruajnë letër për paanshmëri para fillimit të procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes.

- Komisioni i vlerësimit dhe përzgjedhjes i komunave vlerëson çdo aplikacion në bazë të kriterëve për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve për përzgjedhje, mban një Procesverbal dhe i miraton rekomandimet dhe vendimet e veta në formë të një Raporti për vlerësim.
- Raporti i vlerësimit i dorëzohet Komitetit Drejtues të projektit për shqyrtim dhe konfirmim.
- Ekipi i vlerësimit dhe përzgjedhjes i komunave ka të drejtë të takohet me komunat e propozuara për përzgjedhje për shqyrtimin dhe konfirmimin e të dhënave të specifikuar në aplikacionin.
- UNDP me shkrim do t'i njoftojë të gjithë aplikuesit për rezultatet e procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes.

12. Kriteret e vlerësimit

Ekipi i vlerësimit i shqyrton të gjitha aplikacionet e pranuar në përputhje me kriteret e përshkuara më poshtë. Vlerësimi i aplikacioneve bëhet në dy faza:

- Kriteret për përmbushjen e kushteve, dhe
- Kriteret e përzgjedhjes.

12.1 Kriteret për përmbushjen e kushteve

1. Nëse është dorëzuar aplikacioni në kohë?
2. Nëse aplikuesi ka statusin e njësisë së vetëqeverisjes lokale (NJVL)?
3. Nëse aplikuesi është komunë e cila nuk është përfshirë, respektivisht nuk ka marrë mbështetje financiare në fazën e parë të projektit (2016-)?
4. Nëse aplikacioni është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me udhëzimet operative të kësaj thirrjeje?
5. A shoqërohet aplikacioni me një Letër Angazhimi (Shtojca 1) – deklaram se komuna do të përmbushë parakushtet kryesore për pjesëmarrje në projekt nga kapitulli nr.7 i këtyre udhëzimeve operative, e nënshkruar nga Kryetari i komunës dhe Kryetari i Këshillit komunal dhe mban vulën e komunës?
6. A është dorëzuar lista e së paku 60% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit komunal, nga të cilët një e treta janë gra, me përfaqësim politik dhe etnik etj. të cilët kanë shprehur gatishmërinë dhe angazhimin për të marrë pjesë në trajnimet që do të organizohen në kuadër të Programës për Zhvillimin e Kapaciteteve në kuadër të projektit (shtojcë ndaj Letrës për angazhim);
7. A është dorëzuar aplikacioni në origjinal apo i përkthyer në gjuhën maqedonase (në qoftë se aplikacioni është dorëzuar në një gjuhë tjetër)?

E rëndësishme: Çdo aplikacion që nuk do të jap përgjigje pozitive (PO) për të gjitha kriteret e mësipërme për përmbushjen e kushteve, nuk do të merret parasysh për vlerësimin dhe përzgjedhjen e mëtejshme.

12.2 Kriteret e përzgjedhjes

Aplikimet të cilat i kanë kaluar kriteret për përmbushjen e kushteve do të vlerësohen në bazë të kriterëve të përzgjedhjes sipas kriterëve dhe pikave të përcaktuara, siç përcaktohet më poshtë në kriteret e vlerësimit.

Numri maksimal i pikave që aplikantët mund t'i marrin është 100. Vetëm aplikacionet që kanë fituar së paku 70 pikë do të merren parasysh për përzgjedhje, sipas rankimit.

Kriteret e përzgjedhjes

	Pikat maksimale	Pyetje në aplikacion
A. Kalendar i qartë buxhetor dhe pasqyrë cilësore e buxhetit të propozuar - niveli i angazhimit të Komisionit për punë financiare dhe buxhet (KFB) dhe Këshillit komunal	20	2A
A1. Nëse në komunën tuaj është miratuar një Kalendar buxhetor nga Këshilli i Komunës?	3	A1
A2. Ju lutemi përshkruani shkurtimisht procesin e përgatitjes të kalendarit buxhetor për vitin 2021 në NJVL-në tuaj	3	A2
A3. Ju lutemi përshkruani shkurtimisht se në çfarë mënyre dhe në çfarë niveli është angazhuar Komisioni për punë financiare dhe buxhet në procesin e përgatitjes së kalendarit buxhetor për vitin 2021 në NJVL-në tuaj	6	A3
A4. Ju lutemi përshkruani shkurtimisht në çfarë mënyre dhe në çfarë shkalle është angazhuar Këshilli i Komunës në procesin e përgatitjes së kalendarit buxhetor për vitin 2021 në NJVL-në tuaj	6	A4
A5. Ju lutemi përshkruani procesin e zbatimit të kalendarit buxhetor gjatë përgatitjes të Buxhetit të Komunës në vitin aktual për vitin e ardhshëm:	2	A5
B. Përpyekjet dhe mekanizmat ekzistues për pjesëmarrje qytetare (Forumet e Komuniteteve dhe / ose mekanizma të tjerë)	20	2B
B1. Ju lutemi specifikoni format me të cilat e siguron pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje në komunën tuaj	4	B1
B2. Ju lutemi përshkruani shkurtimisht shembullin e fundit për të cilin keni siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në komunën tuaj për iniciativat me interes për qytetarët, sektorin e biznesit, OJQ-të, grupet e marginalizuara dhe të prekshme dhe palët e tjera të interesuara	10	B2
B3. Nëse në komunën tuaj mbahen Forume në komunitete	2	B3
B4. Nëse mbahen, ju lutemi tregoni numrin e forumeve të mbajtura në periudhën janar 2018 - qershor 2021	4	B4
C. Ekzistimi i kuadrit për auditimin e brendshëm dhe ekzekutimin e tij	10	2B
C1. Ju lutemi tregoni numrin e auditimeve të brendshme të kryera në NJVL-në tuaj në periudhën janar 2018 - qershor 2021	3	B1
C2. Ju lutemi tregoni numrin e auditimeve të brendshme të kryera në subjektet e sektorit publik në nivelin e NJVL-së tuaj (komuna disponon me të drejtat themeluese) në periudhën prej janarit të vitit 2018 deri në qershor të vitit 2021	1	B2
C3. Nëse në komunën tuaj nuk ka auditor të brendshëm, ju lutemi përshkruani shkurtimisht në çfarë mënyre është bërë auditimi i brendshëm në NJVL-në tuaj, gjegjësisht, shpjegoni se në çfarë mënyre merrni këshilla për realizimin e objektivave të NJVL-së	3	B3
C4. Ju lutemi shënoni numrin e auditimeve të kryera të raporteve financiare në NJVL-në tuaj në periudhën janar të vitit janar 2018 – qershor të vitit 2021	3	B4
Ç. Shqyrtimi cilësor i raporteve financiare dhe raporteve të auditimit të brendshëm dhe monitorimi i përmirësimeve	10	2Ç
Ç1. Ju lutemi shpjegoni procesin e shqyrtimit të raporteve financiare (komuna, Ndërmarrja Publike (NP) dhe Drejtoria Publike (DP)I dhe subjektet e tjera të sektorit publik ku komuna ka të drejtat themeluese) dhe raportet e auditimit të brendshëm nga Këshilli Komunal dhe Komisionet kompetente	5	Ç1
Ç2. Ju lutemi përshkruani mekanizmat e përdorur nga Këshilli Komunal për monitorimin e përmirësimeve të propozuara me raportet financiare dhe raportet e auditimit	5	Ç2

D. Reagimi në lidhje me rekomandimet e Komisionit për mundësi të barabarta dhe Komisionit për marrëdhënie midis komuniteteve	10	2D
D1. Nëse në komunën tuaj ekziston një Komision për Mundësi të Barabarta mes Grave dhe Burrave	2	D1
D2. Nëse ekziston ky Komision, ju lutemi përshkruani se në çfarë mënyre Këshilli është i përfshirë në shqyrtimin e rekomandimeve të Komisionit	3	D2
D3. Nëse në komunën tuaj ekziston Komisioni për mundësi të barabarta mes komuniteteve	2	D3
D4. Nëse ekziston ky Komision, ju lutemi përshkruani se në çfarë mënyre Këshilli është i përfshirë në shqyrtimin e rekomandimeve të Komisionit	3	D4
DH. Gatishmëria për të instaluar dhe administruar e-tabelën kontrolluese të ueb-faqeve të komunave me të dhëna për ekzekutimin e buxhetit në baza tremujore dhe vjetore.	15	2DH
DH1. Ju lutemi përshkruani se në çfarë mënyre dhe ku komuna e juaj i publikon të dhënat për punën financiare dhe ekzekutimin e buxhetit dhe sa shpesh ato i përditëson (azhurnon)	6	DH1
DH2. Ju lutemi tregoni cilat mekanizma i përdor komuna e juaj për të forcuar transparencën e funksionimit të saj të përgjithshëm të punës	9	DH2
E. Çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën e Këshillit të Komunës	15	2E
E1. Ju lutemi tregoni se çfarë lloj informacionesh dhe dokumentesh që kanë të bëjnë me punën e Këshillit të komunës tuaj janë publikisht në dispozicion	5	E1
E2. Ju lutemi tregoni mënyrat në të cilat anëtarët e këshillit të komunës komunikojnë me qytetarët	3	E2
E3. Nëse në komunën tuaj ekziston një afat i caktuar për takime midis anëtarëve të këshillit me qytetarët	2	E3
E4. Nëse ka një termin të caktuar, ju lutemi tregoni sa shpesh organizohen takimet	5	E4
Numri maksimal i përgjithshëm i pikave	100	

11.3 Kriteret shtesë

Nëse kriteret e përzgjedhjes i plotësojnë më shumë se 9 komuna, do të zbatohen kriteret shtesë të përzgjedhjes, përmes të cilave do të arrihet ekuilibri maksimal ndërmjet aspekteve gjeografike, etnike, gjinore dhe politike të komunave.

12. Lidhja e marrëveshjeve

UNDP e përgatit Memorandumin për mirëkuptim dhe Marrëveshjen për bashkëpunim me çka më detajisht rregullohen të drejtat dhe detyrimet ndërmjet UNDP-së dhe komunave të përzgjedhura. Gjuha e marrëveshjeve për bashkëpunim në kuadër të projektit është gjuha angleze.